



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tipologji tekstore e Gjuhës B (3)

Ngarkesa: 4 kredite; 60 orë mësimore; 0 leksione / 60 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Njohja, zhvillimi, administrimi i teknikave kryesore të analizës letrare. Zotërimi i instrumentave shprehës të domosdoshëm për komunikimin me shkrim dhe me gojë në gjuhën italiane. Ushtrimi i të menduarit analitik, kritik, logjik dhe krijues gjatë interpretimit të teksteve. Aftësia për të përcaktuar në tekst elementë që karakterizojnë shoqërinë dhe kulturën italiane..

Objektivat specifike lëndore:

1. Leximi, kuptimi, interpretimi i tipologjive të ndryshme tekstuale, si teksti rrëfyes, ai përshkrues, teksti argumentues e informativ, teksti teatral, poetik, publicitar.
2. Të analizojë në mënyrë analitike dhe sintetike një tekst, duke dhënë një vlerësim kritik autonom.
3. Të pasurojë vazhdimisht bagazhin leksikor dhe kulturor.
4. Të zhvillojë kompetencën e komunikimit ndërkulturor.
5. Të analizojë tekstin në komponentët e tij strukturorë, gjuhësorë, jashtëgjuhësor, retorikë dhe stilistikor.

Rezultate të pritshme:

Lenda i drejtohet studenteve të gjuhës italiane të vitit të dytë, (FGJH, UT), dhe kontribuon në përvetësimin e gjuhës dhe letërsisë italiane përmes veprimtarive të karakterit leksikor, morfologjik, sintaksor tekstual e letrar. Përqasja funksionale dhe komunikuese bën që studentët të hyjnë në kontakt me një gjuhë gjithnjë e më komplekse duke pasuruar bagazhin e tyre leksikor, duke u afruar me tematika specifike të kulturës italiane e duke forcuar interesin e tyre për botën, letërsinë, kulturën dhe shoqërinë italiane